



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.330/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “ALFA.I SH.P.K”-Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Halit S. Rama, Perroi i Njelmët”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i dëmeve dhe izolimi komplet i kulmit të palestrës sportive ne Istog”, me nr. të prok: “633-20-1203-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Istog, më datën: 26.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ALFA.I SH.P.K”-Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i dëmeve dhe izolimi komplet i kulmit të palestrës sportive ne Istog”, me nr. të prok: “633-20-1203-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Istog.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i dëmeve dhe izolimi komplet i kulmit të palestrës sportive ne Istog”, me nr. të prok: “633-20-1203-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Istog.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “ALFA.I SH.P.K”-Lipjan, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “ALFA.I SH.P.K”-Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 27.05.2020 me nr.330/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi i dëmeve dhe izolimi komplet i kulmit të palestrës sportive ne Istog”, me nr. të prok: “633-20-1203-5-2-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Istog, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, 60, 64 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.06.2020, ka autorizuar ekspertin profesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt: 12.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1, Operatori Ekonomik ankues “ALFA.I SH.P.K”-pretendon se Komuna e Istogut nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së, Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është të sigurojë mënyrë ma efikase, me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE fitues si OE i suksesshëm pa u siguruar se i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara në njoftimin për kontratë të dosjes së tenderit nuk është në harmoni me nenin 1 të LPP-së. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2, Operatori Ekonomik ankues ” ALFA.I SH.P.K”-pretendon se Komuna e Istogut nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, sipas OE ankues. Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve, andaj trajtimi i OE fitues si OE i suksesshëm pa u siguruar se i ka plotësuar të gjitha kriteret e paraparanë njoftimin për kontratë të dosjes së tenderit nuk është në harmoni me nenin 7 të LPP-së Sepse nëse OE. i shpallur fitues nuk mund të dëshmojë se i posedon të gjitha certifikatat ISO siç janë kërkuar me njoftimin për kontratë të dosjes së

tenderit i bien se është favorizuar nga Autoriteti kontraktues dhe nuk është në harmoni me nenin 7 të LPP-së Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.3, Operatori Ekonomik ankues ” ALFA.I SH.P.K”-pretendon se Komuna e Istogut nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së,sipas OE. ankues . Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. Fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit i cili ka konstatuar se OE. i shpallur fitues i ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara ne FDT. Kurse OE. ankues pretendon se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar këto kërkesa: ISO certifikatën 9001:2015 dhe 14001:2015, ndërsa në nenin 9.1&9.2 të FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht kërkesa 9 është kërkuar: Kompania të jetë e certifikuar me ISO 14001:2015 për dyshe me Epoxid, ISO“9001:2015 shtruarja me Epoxid, ISO 9000:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO 9004:2015 Menaxhimi i Cilësisë”. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar certifikatat të certifikuara me Epoxid, prandaj shihet qartë se OE i lartpërmendur nuk ka plotësuar kërkesën e lartcekur dhe është i papërgjegjshëm. Gjithashtu OE ankues pretendon se OE. i shpallur fitues nuk i ka plotësuar edhe kërkesat e parapara me nenin 9.1 dhe 9.2 lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale ku janë kërkuar disa inxhinier me përvojë profesionale Ekspertja thekson se OE. i shpallur fitues nuk i ka te gjitha certifikatat e kërkuara me ISO STANDARDE siç janë në njoftimin për kontratë të dosjes së tenderit Ekspertja gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të OE fitues nuk ka hasur në këto certifikata ISO 9000:2015 dhe ISO 9004:2015 . Sa i përket pretendimit lidhur me mungesën e stafit të inxhinierëve ky pretendim nuk qëndron sepse OE. i shpallur fitues i ka plotësuar të gjitha kriteret sa i përket stafit të kërkuar për ma tepër shih dokumentacionin e secilit nga stafi veç e veç .

Ekspertja pas shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit konstaton se pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar lidhur me shkeljen e nenin 59 të LPP-së Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4, Operatori Ekonomik ankues ” ALFA.I SH.P.K”-pretendon se Komuna e Istogut nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së, sipas OE ankues. Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është të respektohen kriteret për dhënien e kontratës andaj OE ankues pretendon se AK-së e ka shkelur këtë nenë duke e shpërblyer me kontratë OE. të pa përgjegjshëm. Ekspertja thekson se pretendimi është pjesërisht i bazuar sepse është shpërblyer me kontratë OE pa u siguruar se është tenderi i përgjegjshëm me çmim ma të ulët. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese i

propozon panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit ekonomik ta APROVOJË SI PJESËRISHT TË BAZUAR (për arsyet që u cekën tek përgjigjeje në secilin pretendim) dhe i rekomandon panelit shqyrtues që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.06.2020, me anë të shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues, mirëpo të njëjtit nuk kane kthyer përgjigje.

Operatori Ekonomik, me datë: 12.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 26.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “ALFA.I SH.P.K”-Lipjan, se autoriteti kontraktues Komuna e Istogut nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor dhe shkresat e lëndës sqaron se ky pretendim ankimor është i pa bazuar për faktin se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “Halit S. Rama, Perroi i Njelmët”-Prishtinë ka plotësuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njëherit ka ofertuar me çmimi prej 67,648.30 euro. Andaj, AK gjatë vlerësimit të ofertave ka pasur parasysh nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “ALFA.I SH.P.K”-Lipjan, se autoriteti kontraktues Komuna e Istogut nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të cilat i ka dërguar autoriteti kontraktues përmes shkresës më numër të referencës “zyra e prokurimit ISTOG//633/20/011/521” me titull “sqarim lidhur me ekspertizën nr.330/20 datë;12/6/2020” sqaron se AK me rastin e vlerësimit të ofertave ka vepruar konform nenit 7 duke i trajtuar në mënyrë të barabartë OE dhe nuk ka diskriminuar OE ankues. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “ALFA.I SH.P.K”-Lipjan, se autoriteti kontraktues Komuna e Istogut nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së për shkak se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar këto kërkesa: ISO certifikatën 9001:2015 dhe 14001:2015, ndërsa në nenin 9.1&9.2 të FDT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, përkatësisht kërkesa 9 është kërkuar: kompania të jetë e certifikuar me ISO 14001:2015 për dysHEME me Epoxid, ISO “9001:2015 shtruarja me Epoxid, ISO 9000:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësisë, ISO 9004:2015 Menaxhimi i Cilësisë”. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar certifikatat të certifikuara me Epoxid, prandaj shihet qartë se OE i lartpërmendur nuk ka plotësuar kërkesën e lartcekura dhe është i papërgjegjshëm. Gjithashtu OE ankues pretendon se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar edhe kërkesat e parapara me nenin 9.1 dhe 9.2 lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale ku janë kërkuar disa inxhinier me përvojë profesionale. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të cilat i ka dërguar autoriteti kontraktues përmes shkresës më numër të referencës “zyra e prokurimit ISTOG//633/20/011/521” me titull “sqarim lidhur me ekspertizën nr.330/20 datë 12/6/2020” sqaron se kësaj shkrese i janë bashkangjitur këto certifikata: ISO 14001:2015, Sika PU and epoxy resin system, ISO 9001:2015 quality management system, Deklaratë e biznesit “Urb Pro” dt. 20.01.2019 lidhur me përvojën e inxhinierit Daut Retkoceri, referencë pune për Daut Retkoceri e lëshuar nga “Izolimi Construction” e datës 02.10.2017, njoftim mbi emërimin e menaxherit të projektit Daut Retkoceri dt.17.04.2020 nga “Izolimi Construction”, Diploma e kualifikimit universitar lëshuar nga UP me 06.02.2006, si dhe disa dokumente tjera të cilat i kemi bashkangjitur si më poshtë që kanë të bëjnë me certifikatat ISO siç i ka kërkuar AK në dosje të tenderit:





përfundim se AK ka bërë ekzaminimi e tenderëve konform nenit 59 duke i vlerësuar dhe krahasuar tenderët në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Po ashtu, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me rastin e vlerësimit të ofertave ka pasur parasysh që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, sepse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim dukshëm më të lirë se oferta e operatorit ekonomik ankues në shumë prej rreth 20,000.00 euro. Pra, autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Istog

1x1 OE –“ALFA .I SH.P.K”-Lipjan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.